# BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE

## RAPORTE FINANCIARE PERIODIKE

*(Sipas kerkesave te rregullores Nr.60, date 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise, ndryshuar me Vendim Nr.25 dt 1.04.2015)*

## PERMBAJTJA:


1. Informacion i përgjithshëm
2. Shënime për pasqyrat financiare dhe politikat kontabël
3. Bilanci kontabël dhe zërat jashtë bilancit të përmbledhura
4. Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve
5. Tregues të rentabilitetit të bankës
6. Struktura e Kapitalit rregullator
7. Mjaftueshmëria e Kapitalit
8. Klasifikimi i portofolit të financimeve sipas sektorëve
9. Klasifikimi i portofolit të financimeve sipas tipit të industrisë
10. Klasifikim i portofolit të financimeve sipas shpërndarjes gjeografike
11. Klasifikimi sipas maturitetit të mbetur
12. Fondet për provigjione dhe lëvizjet gjatë periudhës
13. Rreziku i financimit sipas metodës standarte
14. Fondet për provigjione dhe lëvizjet gjatë periudhës
15. Rreziku i Likuiditetit
16. Ekspozimi ndaj risqeve dhe Vlerësimi i tyre

## Hyrje

## 1. Informacion i përgjithshëm

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si “Banka” ose “UBA”) është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Bazuar ne nenet e Statutit te saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Proçedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licensën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, te datës 2 korrik 1998,”Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Aksioneret kryesore jane:

| | | |
|---|---|---|
| Eurosig Sh.a. | | **66.26%** |
| Banka Islamike per Zhvillim | | **31.87%** |
| Investitorë të tjerë | - Arabia Saudite | **1.87%** |

| | |
|---|---|
| Kapitali i rregjistuar: | 2,227,176 mije Leke, |
| Numri i aksioneve: | 780,104 |
| Aksione të zakonshme me vlerë nominale secili: | 2,854.97 Leke |

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 4 qytetet Tirane, Shkoder, Fier dhe Durres si dhe ka dy agjenci të vendosura në Tiranë. Më 31 Dhjetor numri i të punësuarve është 96 (2021: 88).

Banka e Bashkuar e Shqipërisë ushtron aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë bazuar ne licencen Nr.03/1 akorduar nga Banka e Shqipërisë, duke ofruar sherbimet/produktet si vijon:

- Të gjitha format e financimeve, duke përfshirë edhe financimin konsumatore dhe financimin hipotekore;
- Qiranë financiare;

- Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke perfshirë kartat e kreditit dhe te debitit, ceqet e udhetarit,ceqet bankare dhe kartat e pagesës;
- Ofrimin e garancive;
- Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një kembim valutor, në një treg të vetorganizuar(OTC) ose ndryshe si më poshtë:
  i) Instrumente të tregut të parasë (ceqe,dëftesa,certifikata të depozitave etj),
  ii) Këmbim valutor,
  iii) Instrumenta te kembimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së fitimit, duke përfshirë këtu produkte te tilla, si marreveshje swap dhe marreveshje që përcaktojnë vleren e fitimit në të ardhmen.
- Ofrimin e sherbimit te kasave te sigurimit;
- Sherbimet keshilluese, ndermjetes dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha vemprimtarite e listuara ne pikat 2 deri 6 si me siper.

## Struktura, kualifikimet dhe përgjegjësitë e Organeve Drejtuese

### *Këshilli Drejtues*

| | |
|---|---|
| Emina Sisic | -Kryetar |
| Mohamad Al Midani | -Anetar |
| Selami Xhepa | -Anetar |
| Mateo Spaho | -Anetar |
| Jemin Gjana | -Anetar |
| Ilir Çekiri | -Anetar |
| Muhammed Furkan Unal | -Anetar |

**Kualifikimet:**

*Emina SISIC (Kryetar)* Ka përfunduar studime Bachelor në Ekonomi në Universitetin e Sarajevës. Gëzon titullin Ekspert Kontabël i Çertifikuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Federatës së Bosnje Hercegovines. Znj. Sisic, gëzon titullin Master në Drejtim nga Universiteti i Sarajevës si dhe Master në Administrim Biznesi Ndërkombëtar nga Griffith College, Dublin. Eksperiencë e gjatë në sektorin bankar duke mbuluar pozicione të ndryshme drejtuese.

*Mohamad Al MIDANI (Anetar)*i diplomuar në Kontabilitet në Universitetin e Konkordias, ka shërbyer për një periudhë 18-vjecare prane Bankës Islamike për Zhvillim, prej të cilave 10 vjet si Drejtor I Departamentit të Investimeve, Equity Division, duke drejtuar një ekip prej 10 profesionistësh dhe një portofol investimesh 1.3 miliardë dollarë amerikanë. Gjatë gjithë periudhes së punës në B.I.Zh, midis shumë funksioneve të tjera, ai ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në ushtrimin e kontrollit mbi investimet dhe vendimarrjen e përshtatshme sipasit stadit dhe ecurisë per secilin investim. Gjithashtu, përgjatë tre viteve të fundit ai ka përfaqësuar B.I.Zh. në Këshillin Drejtues të Kuwait Turk Participation Bank. Në të kaluarën ai ka përfaqësuar B.I.Zh. në këshillin drejtues të disa kompanive të tjera ku B.I.Zh. ka investime.

*Selami Xhepa (Anetar) ka* perfunduar studimet ne Fakultetin e Ekonomise ne vitin 1989 ku eshte diplomuar si Ekonomist. Ne vitin 1996 ka mbrojtur doktoraturen dhe gezon titullin "Doktor i Shkencave Ekonomike". Qe nga viti 1989 e deri me sot ai ka mbajtur disa pozicione drejtuese ne fushen akademike dhe me gjere:

Ne dhjetor 1989 fillon pune si Pedagog prane Fakultetit te Ekonomise, Universiteti i Tiranes.

- Ne nentor 1993 – Maj 1998 mban pozicionin e Drejtorit te Qendres Shqiptare per Nxitjen e Investimeve te Huaja, Keshilli i Ministrave;
- Maj 1998 - Qershor 2002 ka punuar si Specialist/Kryespecialist, Deparatmenti i Kerkimeve dhe Politikes Monetare, Banka e Shqiperise;
- Qershor 2002 – Shtator 2005 ka punuar si Menaxher kerkimor, Qendra shqiptare per tregtine nderkombetare, Instituti i Studimeve Bashkekohore;
- Shtator 2005 – Shtator 2009 ka qene Deputet ne Kuvendin e Shqiperise:
- Ne shtator 2013 emerohet Dekan ne Fakultetin e Ekonomise, Instituti Kanadez i Teknologjise;
- Ne Shtator 2015 ka marre pozicionin e Zevendes Rektor per Kerkimin dhe qe prej vitit 2019 eshte emeruar President i Universitetit Europian te Tiranes, pozicion te cilin e mban deri me sot.

Z. Xhepa ka qene dhe eshte mjaft aktiv dhe ne perkthime librash akademik, veprimtari kerkimore dhe studimore per ceshtje qe kane te bejne me tregun, ekonomine, shoqerine si dhe duke ofruar konsulence dhe njohurite e tij ne disa projekte te organizuara nga Banka Boterore, FMN, Zyra Zviceriane per

Kooperim, Ambasada Zvicerjane etj. Nga viti 1997 deri me 2013 ka marre pjese ne disa konferenca nderkombetare ku ka prezantuar punimet me tema si: “Përfshirja financiare, stabiliteti financiar dhe zhvillimi ekonomik”, “Burimet e rritjes Ekonomike dhe zhvillimi local”, “Reformat e Sektorit Financiar” etj.

*Mateo SPAHO (Anetar)* I diplomuar për Ekonomi dhe Financë (Bachelor) në Universitetin e Parmës (Itali). Masteri Shkencor është zhvilluar në po të njëjtin Universitet në Finance & Risk Mangement në vitin 2010. Në këtë periudhë ka punuar për Alleanca Assicurazioni në pedispozimin e planeve të investimit për klientët e kësaj kompanie pjesë e grupit Generali. Në vitin 2010 fillon gjithashtu doktotaturen ne Universitetin e Parmës (Itali) e cila mbyllet ne fundin e vitit 2013 me tematike” Politikat ekonomike, financiare dhe Punësimi gjatë krizave ekonomike”.

Ka punuar në Ministrinë e Financave (Shqiperi) si Këshilltar i Ministrit dhe Përgjegjës i Departamentit te Parashikimeve Makroekonomike dhe Fiskale. Ka punuar si pedagog i brendshem ne U.E.T. deri ne fillim te vitit 2016 duke marre gjithashtu titullin Profesor i Asociuar pranë Universitetit Bujqesor te Tiranës. Prej muajit Shkurt 2016 Prof. Spaho u përzgjodh si Përgjegjës i Departamentit të Financë Bankës pranë Kolegjit Universitar Luarasi dhe prej Nëntorit 2017 Dekan i Fakultetit Ekonomik.

*Jemin Gjana (Anetar)* zotëron diplomë universitare me date 20.08.1984 si “Ekonomist Plani i Larte” nga Fakulteti i Ekonomise Agrare, Instituti i Larte Bujqesor. Me pas ka kryer kualifikime pasuniversitare prane Universitetit te Tiranes, perkatesisht ne vitin 1986 ne Fakultetin e Historise dhe Filologjise per gjuhe ruse, ne vitin 1987 ne Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike per filozofine marksiste – leniniste si dhe ne vitin 1990 ne Fakultetin e Ekonomise per ekonomi politike. Disa nga pervojat e tij te punes jane:

1975 – 1991 Ekonomist ne sektoret e Bujqesise dhe Ndertimit (Kukes dhe Pogradec);
1992 – 2013 Deputet i Kuvendit te Shqiperise;
2005 – 2009 Minister i Bujqesise Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

Gjate pervojes se tij parlamentare, z. Gjana ka mbajtur disa funksione te rendesishme ne komisione te ndryshme parlamentare qe lidhen me ceshtjet e ekonomise, nder te cilat mund te vecojme:

1992 – 1994 Kryetar i Komisionit Parlamentar te Ekonomise dhe Financave;
1997 – 2001 Zv.Kryetar i Komisionit Parlamentar te te Ekonomise dhe Financave;
2001 – 2003 Kryetar i Komisionit Parlamentar te Bujqesise;
2004 – 2005 Kryetar i Komisionit Parlamentar te Veprimtarive Prodhuese Tregtise dhe Industrise;

2009 – 2013 Kryetar i Komisionit Parlamentar te Veprimtarise Prodhuese Tregtise dhe Industrise.

*Ilir Çekiri(Anetar)* zotëron diplomë universitare ne programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë niveli bachelor ne Fakultetin e Ekonomise dhe Niveli Master Shkencor MBA ne Administrim Biznesi. Ky formim eshte shume i pershtatshem per profilin e punes se tij dhe detyrave te ngarkuara ne banken tone. Pervoja e tij e punes ne sistemin bankar prej tete (8) vitesh ne kredidhenie dhe administrim, eshte nje pervoje profesionale shume e rendesishme dhe e çmuar qe i sherben drejtperdrejte per kryerjen me sukses te detyrave te ngarkuara.
Z. Çekiri eshte njohes i mire edhe i ligjeve dhe rregulloreve te zbatueshme ne sektorin bankar ne Shqiperi, dhe jo vetem i biznesit dhe ekonomise, i produkteve dhe proceseve bankare. Kjo e ben ate te orientuar jo vetem drejt shtimit te biznesit por edhe drejt perputhshmerise me rregullat dhe minimizimin e rreziqeve per çdo transaksion. Per rrjedhoje ai ka gjithe njohurite dhe aftesite e nevojshme per nje vendimmarrje te mire dhe efikase qe do t'i sherbeje nje veprimtarie te sigurt e te qendrueshme te bankes.
Edhe gjate kohes se ushtrimit te detyrave ne Universitetin CIT, z. Çekiri ka qene konsulent i jashtem i Fibank verifikuar me kontrate dypaleshe te lidhur me banken. Njekohesisht expert biznesi per COORP duke kryer disa sherbime qe nga pergatitja e buxhetit, analizen e tregut, identifikim te risqeve ne tregun vendas dhe raportimet tek Menaxheri i projektit, konfirmuar me kontrate midis paleve.

*Muhammed Furkan Unal(Anetar)* I diplomuar ne Universitetin e Uludag (Turqi). Masteri Shkencor per Finance është zhvilluar në Universitetin Istanbul Bilgi (Turqi) dhe eshte duke perfunduar Doktoraturen prane te njejtit universitet. Aktualisht z. Muhammed Furkan Unal shërben si Drejtor Finance (CFO) që nga Janar 2018 në Kardemir Group, Turqi. Përveç detyrave të tij kryesore në çështjet financiare, z. Unal ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushen e menaxhimit strategjik, krijimin e vlerës, transparencës dhe transformimit dixhital. Gjithashtu, nga viti 2022 mban pozicionin e Drejtorit te Pavarur prane Zaman Islamic Bank Kazakistan.

Z. Unal, gjate karrieres se tij, ka mbajtur pozicione te ndryshme drejtuese ne fushen bankare dhe financiare si: Shef i Grupit për Financat dhe Investimet e Korporatave dhe Zv.President Ekzekutiv ne Bordin Drejtues te Aktif Investment Bank A.Ş ne periudhen 2013 - 2015. Anëtar i Bordit të Drejtorëve në filialet e ndryshme të bankes dhe si Kryetar i Bordit në një prej tyre. Anëtar i Bordit Ekzekutiv te Qendrës se Projekteve Financiare të Stambollit dhe Anëtar Bordi i një fondi themeluar në partneritet me Bankën Islamike për Zhvillim. Z. Unal ka sherbyer si konsulent i CEO-s dhe Bordit të Drejtorëve të TAIB Investment Bank, një bankë globale investimesh e themeluar në Bahrein dhe e lidhur me Grupin Dubai.

z. Unal është përfshirë aktivisht në projekte të rëndësishme në vende të ndryshme jashtë Turqisë, si p.sh si Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Somalia, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajti, Kenia, Bahreini, Irani, Kazakistani, Somalia, Turkmenistani dhe Britania e Madhe

**Përgjegjësitë:**

1. Këshilli drejtues, në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë dhe politikat e miratuara, si dhe në fitimin më të mirë të saj, shqyrton dhe vlerëson:
   a. zhvillimin dhe mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të ekspertizës profesionale në përputhje me rritjen dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës;
   b. sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës;
   c. njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
   d. parandalimin dhe shmangien e konflikteve të mundshme të fitimit në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e bankës; si dhe
   e. mbrojtjen e fitimeve të klientëve, investitorëve dhe të publikut në përgjithësi.
2. Miraton dhe kontrollon zbatimin e politikave dhe strategjive te bankes, ne perputhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor;
3. Percakton objektivat afatgjate te bankes dhe monitorimin e realizimit te ketyre objektivave;
4. Monitorimin e efektivitetit te praktikave te drejtimit te bankes dhe kryerjen e ndryshimeve te nevojshme per permiresimin e ketyre praktikave;
5. Krijon komitet, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin fitim të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
6. Përcakton kushtet dhe standardet për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;
7. Monitoron dhe trajton konfliktet e mundshme të fitimit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të fitimit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
8. Merr masat e nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
9. Monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;
10. Mbikëqyr procesin e dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

## *Komiteti i Kontrollit*

Emina Sisic -Kryetare
Mohamad Al Midani - Anëtar
Orjana Kalaja - Anëtare

**Kualifikimet:**

*Zj.Emina Sisic*

Ka përfunduar studime Bachelor në Ekonomi në Universitetin e Sarajevës. Gëzon titullin Ekspert Kontabël i Çertifikuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Federatës së Bosnje Hercegovinës. Znj. Sisic, gezon titullin Master ne Drejtim nga Universiteti i Sarajevës si dhe Master në Administrim Biznesi Ndërkombëtar nga Griffith College, Dublin. Eksperiencë e gjatë në sektorin bankar duke mbuluar pozicione të ndryshme drejtuese.

*Z.Mohamad Al Midani*

I diplomuar në Kontabilitet në Universitetin e Konkordias, ka shërbyer për një periudhë 18-vjecare prane Bankës Islamike për Zhvillim, prej të cilave 10 vjet si Drejtor I Departamentit të Investimeve, Equity Division, duke drejtuar një ekip prej 10 profesionistësh dhe një portofol investimesh 1.3 miliardë dollarë amerikanë. Gjatë gjithë periudhes së punës në B.I.ZH, midis shumë funksioneve të tjera, ai ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në ushtrimin e kontrollit mbi investimet dhe vendimarrjen e përshtatshme sipasit stadit dhe ecurisë per secilin investim. Gjithashtu, përgjatë gjashte viteve të fundit ai ka përfaqësuar B.I.ZH. në Këshillin Drejtues të Kuwait Turk Participation Bank. Në të kaluarën ai ka përfaqësuar B.I.Zh. në këshillin drejtues të disa kompanive të tjera ku B.I.ZH. ka investime.

*Zj. Orjana Kalaja*

E diplomuar për Financë dhe Kontabilitet pranë Universitetit te Tiranes. Qe prej vitit 2011 eshte anetare e Institutit te Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, ne Mbreterine e Bashkuar, dhe gëzon titullin FCCA, dhe prej 2012 anëtare e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, në Shqipëri, dhe gëzon titullin Audituese Ligjore. Ajo ka nje përvojë 19 vjecare në auditimin e jashtëm dhe të brendshëm dhe shërbime të tjera financiare. Eshte e specializuar në ofrimin e shërbimeve të auditimit të jashtëm dhe këshillimit financiar për një sërë klientësh të mëdhenj të sektorit privat dhe publik. Prej më shumë se 5 vitesh drejton si Partnere Drejtuese një Shoqëri Auditimi në Shqipëri e cila është pjesë e rrjetit të 10 shoqërive audituese më të mëdha në Botë.

**Përgjegjësitë:**

1. Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e proçedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
2. Shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
3. Propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;
4. Bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
5. Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;
6. I jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
7. Miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

## *Drejtoria*

Orfea Dhuci - CEO

**Kualifikimet:**

Eshtë diplomuar per Finance në vitin 1984 pranë Universitetit te Tiranes, Fakulteti Ekonomik. Me pas ka perfunduar Doktoraturen ne vitin 1993 pranë Universitetit te Tiranes, Fakulteti Ekonomik si dhe ne vitin 1990 ka marre titullin Kandidat i Shkencave pranë Universitetit te Tiranes, Fakulteti Ekonomik dhe ne vitin 2004 titullin Profesor i Asociuar pranë Universitetit te Tiranes, Fakulteti Ekonomik.
Z. Orfea Dhuci ka mbi 33 vjet eksperiencë në veprimtarinë bankare, dhe gati 40 vjet eksperience akademike në fushat e veprimtarisë bankare, drejtimit bankar, kontabilitetit bankar, drejtimit të riskut, sistemeve të kontrollit të drejtimit e të sistemeve të brendshme të kontrolleve të bankave etj.

Ai ka filluar si pedagog i Fakultetit të Ekonomisë, për financat, paranë e kredinë dhe me vone ka qene një nga themeluesit e programeve të mësimdhënies për bankat, politikat monetare dhe mbikëqyrjen bankare.

Në fillim të viteve 90-të u shkëput nga pedagog i brendshëm dhe ju përkushtua veprimtarisë bankare fillimisht si drejtor banke e me vone si zëvendës drejtor dhe me vone si këshilltar i Këshillit Drejtues të bankës për qeverisjen korporatave dhe sistemet e brendshme të kontrollit. Njëkohësisht ka vijuar mësimdhënien në universitete. Po kështu ka marrë pjese në hartimin e mjaft ligjeve në fushën e financës e të veprimtarisë bankare. Ai ka qene, po kështu, i angazhuar në

botimin e disa librave për drejtimin e bankave dhe për veprimtarisë bankare duke u fokusuar më shumë në drejtimin e risqeve dhe ndërtimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të bankave. Z. Dhuci është edhe autor i fjalorit terminologjik bankar i botuar nga Akademia e Shkencave.

Z. Dhuci ka qene Kryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes se Burses së Tiranës dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duke dhënë një kontribut të madh në vendosjen e standardeve kombëtare dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit e të raportimit financiar.

Që nga viti 1998 ai ka qënë drejtues i Alpha Bank Albania në pozicione të ndryshme drejtimi dhe ka pasur në varësi një numër të rëndësishëm njësish dhe punonjësish, duke arritur deri ne 320 punonjes. Nga informacionet dhe analizat e bëra nga banka ka rezultuar se ka aftësi drejtimi shume të mira dhe di të organizoje, të drejtoje e të motivoje punonjësit për arritjen e objektivave të tyre dhe të objektivave të bankës, njekohesisht duke ndërtuar raporte profesionale me punonjësit dhe nxitur punën në ekip.
Z. Dhuci karakterizohet nga aftësi për të ndërtuar marrëdhënie të rregullta e korrekte me autoritetet e veprimtarisë bankare e financiare si edhe me autoritetet e tjera duke respektuar kuadrin rregullator të vendosur nga ato. Z. Dhuci është një profesionist e pajisur me kualifikimet e duhura, në fushën e drejtimit bankar, drejtimit të riskut, përputhshmërisë, qeverisjen korporatave dhe sistemit të kontrolleve të brendshme. Gjate karrierës së tij profesionale i është dashur të hartoje e të miratoje një numër të madh politikash, procedurash dhe manualesh të domosdoshme për mbarëvajtjen e bankës e të veprimtarisë se saj.

Përgjegjësitë:

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.
2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.
3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar Banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.
4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.


Asambleja e Pergjithshme
Keshilltari I Sheriatit
Keshilli Drejtues
Komiteti I Kontrollit
Departamenti I Kontrollit te Brendshem
Komiteti i Shpërblimeve
Komiteti i RrezikutALCO)
Komiteti I Financimeve
Komiteti I Burimeve Njerezor
Komiteti I Rikuperimit te Financimeve
Komiteti Perputhshmerise
Komiteti I TIK
Komiteti BCM
Drejtori i Pergjithshem
Grupi I Biznesit
Grupi Mbeshtetes
Departamenti I Individeve
Departamenti I Korporateve
Departamenti Thesarit dhe Institucioneve Financiare
Departamenti Rrezikut
Departamenti Juridik
Depart. Burimeve Njerezore & Administrates
Dept.Finances & Planifikimt Strategjik
Departamenti Operacional
Departamenti TIK
Njesia e Financimeve
Njesia e Mardhenieve me Klientet Korporate
Njesia e Manaxhimit te Rreziqeve
Njesia e Administrates
Njesia e Administrimit te Portofolit te Financimeve
Njesia e Zhvillimit te Produkteve dhe Marketingut
Njesia e Mardhenieve me Klientet SME
Njesia e Perputhshmerise dhe Pastrimit te Parave
Njesia e Sigurise
Njesia Back Office dhe Procesimit te Pagesave
Njesia e Mbledhjes se Hershme te Financimeve
Njesia e Mbledhjes dhe Rikuperimit te Financimeve
Deget dhe Agjensite

## 2. Shenime per pasqyrat financiare dhe politikat kontabel

### 1. Vlerësimi i menaxhimit për aftësinë për vazhdimësi të aktivitetit

Në mënyrë që të përmbushte kërkesat e kapitalit, të limitohen risqet nga ekspozimet e mëdha dhe për vazhduar aktivitetin e saj, në vitin 2011, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, vendosi të përthithte humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2010 dhe të rriste kapitalin e paguar.
Pas injektimit të kapitalit shtesë, Manaxhimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk cënohet. Për këtë arsye, Banka i ka përgatitur te dhenat financiare mbi bazat e vazhdimësisë së biznesit.

### 2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit dhe përmbajtjen e raportimit financiar" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF është aprovuar për qellime rregullatore, në perputhje me Nenin 47 të Ligjit Nr 9662, të datës 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë" ("Ligji Bankar").

### 3. Politikat kryesore kontabile

#### (a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvec aktiveve të marra nga proceset gjyqësore, të cilat janë të matura me vlerën reale.

#### (b) Arka dhe mjete monetare të ngjashme

Arka dhe mjetet monetare të ngjashme përfshijnë gjendjen e arkës, balancat me Bankën Qëndrore (përvec rezervës së detyrueshme) si dhe balancat me bankat dhe institucionet e tjera financiare me date shlyerje dhe norme fitimi te paracaktuar.

#### (c) Te drejtat prej aktiviteteve financuese

Financimet dhe të tjera të pagueshme regjistrohen në bilanc pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulim humbjesh nga financimet. Financimet dhe të tjera të pagueshme janë të njejta me huatë dhe paradhëniet për klientët.
Fondet rezervë për mbulim humbjesh janë krijuar në përputhje me rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë "Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë" (Rregullorja e Re e Kredisë), e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 14 shtator 2011,e amenduar. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në kategori rreziqesh të meposhtme. Për cdo kategori të rrezikut, aplikohen normat e fondeve rezervë si më poshtë:

| LLOJI I HUASË | NORMA E FONDIT |
|---|---|
| Standarde dhe jo të kthyera në afat | 1% |
| Në ndjekje | 5% |
| Nën standard | Jo me pak se 20% |
| Të dyshimta | Jo me pak se 50% |
| Të humbura | Jo me pak se 100% |

Shumat për financimet e dhëna raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për aktivitetet financuese që klasifikohen si nënstandard, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga aktivitetet financuese që klasifikohen si standarde dhe në ndjekje, regjistrohen si provigjion statistikor në anën e detyrimeve të bilancit kontabël. Banka nuk përllogarit të ardhura përfinancimet me probleme.

## (d) Bono Thesari

*Bono Thesari-të mbajtura-deri në maturim*

Keto Bono thesari konta*bilizohen me cmimin e blerjes dhe me te ardhuren e përllogaritur për kuponat që do të paguhen. Cdo zbritje apo prim i përfituar* mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përllogaritur deri ditën e maturimit dhe pagesës. Këto Bono Thesari konsiderohen si të mbajtura deri në maturim meqënese Banka ka ndërmend t'i mbajë ato në baza të afatgjata deri në maturitet. Provigjionimi kontabilizohet kur ka gjasa të mëdha që Banka nuk i zotëron dot këto letra deri në maturim për shkak të rrethanave të reja, ose në qoftë se ka një risk të dështimit nga lëshuesi i letrës me vlerë.

## (e) Investime ne Mudaraba

Investimet ne Mudaraba jane bashkepjesemarrje, ku Banka luan rolin e investitorit me kapital per sipermarresin ('Mudarib') me qellim marrjen pjese ne nje aktivitet investues. Kur shuma e investimit pritet te jete me e ulet se vlera kontabel ne terma afatgjata e investimit, provigjonet nga zhvleresimet njihen si fitim/humbje.

## (f) Aktive të qëndrueshme

Aktive të qëndrueshme paraqiten me koston e tyre pasi të jetë zbritur zhvlerësimi i akumuluar, i cili është i përllogaritur në baza lineare mbi jetëgjatesinë e vlerësuar të përdorimit të aktiveve. Jetëgjatësite e vlerësuara, përdorur për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

- Ndërtesa 20 vite
- Automjete 5 vite
- Pajisje zyre 5 vite
- Kompjutera dhe pajisje elektronike 4 vite

- Mobilje dhe pajisje 5 vite
- Aktive te paprekshme 4 vite

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e përdorshme dhe vlerat e mbetura rishikohen në cdo fund të vitit financiar dhe rregullohen në qoftë se është e nevojshme. Kostot për riparimet në ambientet me qira, janë të përfshira në aktive të tjera si "Shpenzime që amortizohen nëpër vite" dhe janë të amortizueshme për pese vjet.

### (g) Aktive të marra përmes proceseve gjyqësore

Aktivet e marra nëpërmjet proceseve gjyqësore përbëhen nga kolateralet e marra nga banka për financimet e humbura. Këto aktive mbahen si pronësi investuese dhe rivlerësohen mbi baza të rregullta me referencë me cmimet e tregut.Vlera kontabël e këtyre aktiveve përafërson vlerën e tyre aktuale të tregut.

### (h) Llogaritë e klientëve

Llogaritë e klientëve në princip përfshijnë depozitat e vecanta investuese ku depozituesit udhëzojnë Bankën për të investuar fondet e tyre në investime të vecanta ose me kushte të paracaktuara. Këto depozita investohen nga Banka nën emrin e saj nën kushtet e kontratave specifike Mudareb të nënshkruara me depozituesit. Këto depozita specifike investuese, të cilat janë të klasifikuara brenda llogarive të klientëve, ndajnë fitimin ose humbjen direkte të investimeve të tyre përkatëse në momentin e realizimit, dhe përndryshe nuk marrin pjesë në fitimin ose humbjen e Bankës.

### (h) Shpërndarja e fitimit për klientët

Fitimi i Bankës shpërndahet ndërmjet depozituesve dhe aksionerëve të Bankës në përputhje me parimet e Shariatit Islamik duke përdorur metodën kryesore në grup. Depozituesve ju shpërndahet në llogaritë e tyre pjesa që ju takon nga fitimi në përputhje me maturitetet e kontraktuara të investimeve.

### (i) Regjistrimi i të ardhurave

*Të ardhura nga bankat dhe institucione të tjera financiare*

Të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare regjistrohen mbi bazë përllogaritjeje.

*Kontratat e Financimeve*

Të ardhurat nga kontratat e Financimeve regjistrohen mbi bazë përllogaritjeje.

*Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet*

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe komisionet janë ato që përftohen nga shërbimet financiare të ofruara nga Banka duke përfshirë shërbimet e menaxhimit të mjeteve monetare, të ndërmjetësimit si dhe ato si këshilltar investimi. Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet regjistrohen kur ofrohet shërbimi përkatës.

### (j)Tatimi

Banka e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2021, tatimi mbi fitimin është 15% mbi të ardhurat e tatueshme. Tatim fitimi i pagueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të caktuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve sic kërkohet nga Legjislacioni Shqiptar. Fitimi statutor bazohet në regjistrimet kontabël të mbajtura nga Banka për qellime te Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) dhe mund te ndryshojne në mënyrë thelbësore nga raportimi i pozicionit financiar për qellime rregullatore në përputhje me MRF.

### (k) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin e këmbimit valutor të datës kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e bilancit, janë konvertuar në monedhën matëse me kursin e këmbimit të asaj dite. Diferencat që rrjedhin nga këmbimet valutore regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe pasivet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën matëse me kurset e këmbimit valutor të ditës kur janë kryer transaksionet.
Kapitali aksioner është trajtuar si një zë monetar dhe rivlerësohet në përputhje me politikën e sipërpërmendur. Sipas kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë kapitali në monedhë të huaj duhet të kontabilizohet në bilanc me kursin e ditës kur është kryer transaksioni dhe një zë “Rezervë Rivlerësimi” krijohet në grupin e kapitalit dhe përfaqëson diferencën midis kursit fiks të Bankës së Shqipërisë të fund vitit me kursin historik me të cilin është regjistuar kapitali në monedhë të huaj.

### (l) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të bëjnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë direkt në aplikimin e politikave kontabile dhe në vlerat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Treguesit aktualë mund të ndryshojnë nga ata të parashikuar.

## 3. Bilanci kontabel dhe zerat jashte bilancit te permbledhura

| Bilanci kontabel dhe zerat jashtë bilancit | | |
|---|---|---|
| **AKTIVET** | **Dhjetor 2022** | **Shtator 2022** |
| VEPRIMET THESARI & NDËRBANKARE | **3,962,626** | **3,799,292** |
| Arka dhe Banka qëndrore | 2,575,181 | 2,181,488 |
| Bono thesari | 0 | 0 |
| Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. Financiare | 847,223 | 677,653 |
| Depozita me bankat, institucionet financiare | 535,788 | 590,117 |
| Hua per Bankat & Institucione financiare | 4,433 | 350,034 |
| VEPRIMET ME KLIENTËT | **7,964,049** | **8,398,969** |
| Hua standarte për klientët | 6,643,934 | 7,763,069 |
| Hua në ndjekje | 875,784 | 358,468 |
| Hua nënstandart | 442,416 | 247,539 |
| Fonde rezervë për huatë nënstandart | -94,810 | -54,892 |
| Hua të dyshimta | 198,398 | 174,601 |
| Fonde rezervë për huatë e dyshimta | -101,673 | -89,816 |
| Hua të humbura | 419,124 | 139,166 |
| Fonde rezervë për huatë e humbura | -419,124 | -139,166 |
| MJETE DHE DETYRIME TË TJERA | **549,690** | **343,676** |
| MJETET E PËRHERSHME | **219,510** | **219,452** |
| Interesa pjesëmarrëse | 0 | 0 |
| Mjete të qëndrueshme | 219,510 | 219,452 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | **12,695,874** | **12,761,388** |

| | | |
|---|---|---|
| **PASIVET** | **Dhjetor 2022** | **Shtator 2022** |
| VEPRIMET E THESARIT & NDËRBANKARE | **1,342,442** | **1,150,603** |
| Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet financiare | 7,964 | 33,883 |
| Depozita nga bankat, institucionet financiare | 1,334,465 | 1,116,706 |
| Hua marre nga Bankat dhe institucionet e kreditit | 13 | 14 |
| VEPRIMET ME KLIENTËT | **9,906,562** | **10,088,437** |
| Qeveria Shqiptare & administrata publike | 7,617 | 9,090 |
| Detyrime ndaj klientëve për llogaritë | 9,893,749 | 10,073,749 |
| Llogari rrjedhëse | 2,562,941 | 2,677,890 |

| | | |
|---|---|---|
| Llogari depozitash me afat | 7,330,808 | 7,395,859 |
| Llogari të tjera të klientëve | 5,196 | 5,598 |
| DETYRIME TË TJERA | **127,516** | **87,929** |
| BURIME TË PËRHERSHME | **1,319,355** | **1,434,419** |
| Fondet rezervë specifike | 159,524 | 130,304 |
| Kapitali i aksionerëve | 1,159,831 | 1,304,116 |
| Kapitali i paguar* | 2,227,175 | 1,876,895 |
| Primet e aksioneve | | |
| Rezerva | 159,193 | 159,193 |
| Diferenca e rivlerësimit | -370,417 | -195,932 |
| Fitimi (humbja) i pashpërndarë | -555,097 | -555,097 |
| Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor | -301,023 | 19,058 |
| **TOTALI I PASIVEVE** | **12,695,874** | **12,761,388** |

*Shenime:* Gjatë tremujorit të katert te vitit 2022, Banka ka nje zvogelim prej 430 milion Leke ne aktivitetit financues (ndersa ishte me rritje 49 milion Leke ne tremujorin e trete te 2022) e ndikuar nga ulja e nivelit te kredive te reja per kete periudhe si dhe ripagime perpara kohe te nje pjese te portofolit. Kjo ka sjelle si rezultat nje rritje me te moderuar ne të ardhurat mujore nga financimet, krahasura me periudhen paraardhese. Banka vazhdon te mbaje fondet e lira te investuara ne Institucione Financiare jo rezidente kryesisht per periudha 1 mujore. Në zërat e pasivit, depozitat e klienteve jane rritur, kryesisht prej llogarive rrjedhese dhe depozitat me afat maturimi mbi nje vit dhe kryesisht eshte ndjere rritja ne depozitat me afat maturimi 12 dhe 60 mujore. Gjate kesaj periudhe nuk ka pasur ndonjë shtesë në Kapitalin Aksioner. Në lidhje me rezultatin financiar, impakti pozitiv vjen nga rrimarjet e kryera nga kredite me probleme si dhe rritja e fitimit operacional neto.

## Bilanci kontabel dhe zerat jashte bilancit te permbledhura (vazhdim)

| ZËRAT JASHTË BILANCIT | Dhjetor 2022 | Shtator 2022 |
|---|---|---|
| **ANGAZHIME FINANCIMI** | **258,105** | **292,102** |
| Angazhime të dhëna | 258,105 | 292,102 |
| Angazhime të marra | | |
| GARANCITË | **30,131,991** | **13,077,251** |
| Garanci të dhëna | 40,574 | 40,811 |
| Garanci të marra | 30,091,417 | 13,036,441 |
| TRANKSAKSIONE NE VALUTE | **0** | **0** |
| Valutë e blerë me afat | 0 | 0 |
| Valutë e shitur me afat | 0 | 0 |
| TOTALI | **30,390,096** | **13,369,353** |

## 4. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

| REZULTATI FINANCIAR | 3 mujori i mbyllur ne 31.12.2022 | 3 mujori i mbyllur ne 30.09.2022 |
|---|---|---|
| | | |
| *Të ardhura nga vemprimtari fitimprurese* | **530,300** | **399,517** |
| Për veprimet me bankat | 20,450 | 12,513 |
| Nga veprimet me klientët | 509,850 | 387,003 |
| Nga veprimet me letrat me vlerë | 0 | 0 |
| *Shpenzime per vemprimtari fitimpaguese* | **-119,146** | **-107,964** |
| Për veprimet me bankat | -2,627 | -2,519 |
| Per veprimet me klientët | -116,519 | -105,444 |
| Per veprimet me letrat me vlerë | 0 | 0 |
| Total nga vemprimtarite fitimprurese dhe fitimpaguese | **411,154** | **291,553** |
| Te ardhurat nga komisionet | 105,478 | 80,440 |
| Nga veprimtaria huadhenese | 45,488 | 38,387 |
| Nga sherbimet bankare | 59,991 | 42,053 |
| Shpenzime per komisionet | -6,795 | -5,018 |
| Per veprimtarine huadhenese | -467 | -306 |
| Per sherbimet bankare | -6,328 | -4,713 |
| Fitim/Humbja komisionet neto | **98,683** | **75,421** |
| Fitim / Humbja neto nga veprimtaria valutore | 14,262 | 11,670 |
| Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare | 0 | 0 |
| Shpenzime për personelin | -157,316 | -110,216 |
| Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat | -2,231 | -1,735 |
| Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë | -151,096 | -120,021 |
| Amortizimi I mjeteve të qëndrueshme | -28,283 | -21,147 |
| *Shpenzime për fonde rezervë për huatë standarde & ndjekje* | -121,798 | -86,551 |

| | | |
|---|---|---|
| *Shpenzime fonde rezervë për huatë nenstandarde, dyshimta, humbje* | -653,829 | -204,571 |
| Rimarrje nga fonde rezerve per huate standarte& ndjekje | 103,759 | 84,979 |
| Rimarrje nga fonde rezerve per huate nenstandarte, dyshimta, humbura | 239,628 | 126,054 |
| Shpenzime te tjera per Fonde Rezerve | -70,445 | -44,397 |
| Llogari per t'u arketuar te pambledhshme | 0 | 0 |
| Te ardhura nga veprimet e qirase | 1,491 | 1,045 |
| Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare | -4,796 | -3,183 |
| Fitimi neto nga veprimtarite jo te zakonshme | **19,792** | **20,155** |
| Te ardhura jo te zakonshme | 20,337 | 20,240 |
| Shpenzime jo te zakonshme | -545 | -85 |
| Fitimi para tatimit | -301,023 | 19,058 |
| Tatimi | 0 | 0 |
| FITIMI NETO | **-301,023** | **19,058** |

## 5. Treguesit e rentabilitetit

| Nr | Tregues te rentabilitetit te bankes | Dhjetor 2022 | Shtator 2022 | Qershor 2022 | Mars 2022 | Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kthyeshmeria nga aktivet mesatare (ROAA)(Te ardhurat neto / aktivet mesater*100) | -1.19% | 0.15% | -0.01% | -0.40% | -0.40% |
| 2 | Shpenzime te pergjithshme te veprimtarise/ te ardhurat bruto te veprimtarise | 155% | 91% | 97.00% | 100.30% | 104.00% |
| 3 | Te ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e pergjithshme te veprimtarise | 49% | 105% | 103.00% | 55.02% | 55.02% |
| 4 | Kthyeshmeria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE)(te ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar*100) | -25.95% | 1.46% | 1.60% | -0.10% | -4.30% |
| 5 | Aktive per punonjes (totali I aktiveve / numri I rregjistruar I punonjesve) ne Lek'000 | 135,062 | 140,235 | 148,905 | 148,734 | 119,157 |
| 6 | Te ardhurat neto nga interesi / aktivet mesatare | 1.65% | 0.031 | 1.91% | 2.42% | 2.97% |
| 7 | Marzhi neto nga interesat | 4.34% | 3.60% | 3.44% | 2.52% | 2.75% |
| 8 | Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare | 2.07% | 2.30% | 1.92% | 3.51% | 3.14% |
| 9 | Shpenzimet per interesa / aktivet mesatare | 0.94% | 0.85% | 0.52% | 1.09% | 1.11% |
| 10 | Te ardhurat neto nga interesat / te ardhurat bruto te veprimtarise | 118% | 73.00% | 99.34% | 55.22% | 73.74% |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Te ardhurat neto nga veprimtarite e tjera/ aktivet mesatare | 0.94% | 0.59% | 0.51% | 0.87% | 1.05% |
| 12 | Shpenzimet jo per interesa / te ardhurat bruto te veprimtarise | 62% | 70% | 67.00% | 76.04% | 107.00% |
| 13 | Shpenzime personeli / te ardhurat bruto te veprimtarise | 28% | 28% | 29.00% | 25.41% | 40.00% |
| 14 | Shpenzime/Rimarrje per provigjone / aktive mesatare | -3.66% | -0.35% | -0.77% | -0.40% | -0.51% |

## 6. Struktura e Kapitalit Rregullator

Kapitali rregullator i Bankes ne baze te karakteristikave te tij dhe kushteve te percaktuara ne rregulloren per "Kapitalin rregullator te bankes", ndahet ne dy kategori:

a) kapital i nivelit te pare
b) kapital i nivelit te dyte

a) Kapitali i nivelit I llogaritet si shume e kapitalit baze te nivelit te pare dhe kapitalit shtese te nivelit te pare, duke marre ne konsiderate zbritjet sipas kerkesave rregullatore. Elementet perberes te tij jane:

- kapitali i paguar, i cili perbehet nga aksionet e zakonshme, te cilat mbartin te gjitha karakteristikat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”. Kapitali i paguar perbehet nga aksione te cilat nuk jane preferenciale dhe nuk ka kufizime mbi to;
- primet e ketyre aksioneve;
- fitimet e pashperndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e meparshme, te cilat perfshihen ne kapitalin rregullator vetem me miratimin e asamblese se pergjithshme per pjesen qe parashikohet te jete element perberes se tij;
- fitimi ushtrimor i fundvitit;
- fitimi ushtrimor i periudhes raportues, i cili perfshihet vetem ne rast se plotesohen kushtet e percaktuara ne rregullore;
- rezervat, te cilat perfshijne rezervat ligjore te krijuara me vendim te asamblese se aksionereve ;
- diferencat e rivlersimit kreditore, te cilat jane diferencat qe lindin nga fakti qe per standartet lokale, kapitali i bankes konvertohet ne LEK me kursin ne periudhen raportuese dhe nuk mbahet me kosto historike.

Si ze zbrites i kapitalit baze te nivelit te pare jane:

- humbjet e periudhes raportuese;
- aktivet e patrupezuara;

- pjesen e shumes se pjesemarrjeve te drejtperdrejta ne instrumentet e kapitalit te nivelit te pare ne Filiale, duke konsideruar si pjese te zbritshme, ate qe tejkalon kufirin prej 10% te kapitalit baze te nivelit te pare para zbritjeve ne fjale.

Në datë 31 Dhjetor 2022, kapitali i regjistruar eshte 2,227,176 mije Lek i ndarë ne 780,104 aksione me vlere nominale 22.05 USD per aksion. Struktura e kapitalit rregullator përbëhet nga elementët kryesorë të Nivelit të Parë, Kapitali i nivelit të dytë është zero, pasi Banka nuk ka instrumente të borxhit të varur.

Banka ben llogaritjen e kapitalit rregullator sipas kerkesave te rregullores "Per kapitalin rregullator te bankes", ne fuqi nga data 31.03.2015.

| Zëri | Dhjetor 2022 | Shtator 2022 |
|---|---|---|
| | 1,143,526 | 1,297,005 |
| KAPITALI RREGULLATOR | 1,143,526 | 1,297,005 |
| KAPITAL I NIVELIT TE PARE | 1,143,526 | 1,297,005 |
| KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE | 2,227,176 | 1,876,896 |
| Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1) | 2,227,176 | 1,876,896 |
| Kapitali i paguar | 0 | 0 |
| Zëra memorandumi: Instrumenta kapitali jo të njohura | 0 | 0 |
| Primet e aksioneve | 0 | 0 |
| (-) Instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë | 0 | 0 |
| (-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë | -555,097 | -555,097 |
| Fitimet e pashpërndara | -555,097 | -555,097 |
| Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme | 159,193 | 159,193 |
| Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit) | -370,417 | -195,932 |
| Diferenca rivleresimi kreditore | 0 | 0 |
| Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë | 0 | 0 |
| (-) Emri i mirë | -16,306 | -7,111 |
| (-) Aktive të tjera të patrupëzuara | **16,306** | **7,111** |
| (-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara | | |
| (-) Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe nuk burojnë nga diferencat e përkohshme, të netuara me detyrimet tatimore të lidhura | 0 | 0 |
| (-) Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar | | |
| (-) Pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara në KBN1 | 0 | 0 |
| (-) Teprica e zbritjeve nga zërat e Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë që tejkalojnë Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë | | |
| (-) Pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) jashtë sektorit financiar të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250% | | |
| (-) Pozicionet e titullzimit të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250% | | |
| (-) Transaksione jo DVP (free delivery) të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250% | | |
| (-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme | | |
| (-) Aktive tatimore të shtyra të zbritshme që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme | | |
| (-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme | | |

| | | |
|---|---|---|
| (-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65% | 0 | 0 |
| KAPITALI SHTESE I NIVELIT TE PARE | 0 | 0 |
| Instrumentat e kapitalit të njohura si Kapital Shtesë i Nivelit të Parë | 0 | 0 |
| (-) Instrumentat e veta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë | 0 | 0 |
| (-) tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2) | 0 | 0 |
| KAPITALI I NIVELIT TE DYTE | 0 | 0 |
| Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë | 0 | 0 |
| Metoda Standarte (SA) rregullimet kryesore të rrezikut të financimit | | |

## 7. Mjaftueshmëria e Kapitalit

Kapitali rregullator duhet ne cdo kohe te mbuloje kerkesen per kapital te nevojshem per mbulimin e rrezikut te financimit, te mbulimit te rrezikut te tregut dhe te mbulimit te rrezikut operacional.
Mjaftueshmeria e kapitalit llogaritet si raport ndermjet shumes se kapitalit rregullator me shumen e ekspozimeve te ponderuara me rrezikun, shprehur kjo ne perqindje, ne zbatim te plote te rregulloreve ne fuqi.

Banka llogarit ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementëve të mëposhtëm:

a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e financimit dhe rrezikun e kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit”;
b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të rregullores e Bankës së Shqipërisë “Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit”, të shumëzuara me 12.5;
c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në kreun VIII të rregullores e Bankës së Shqipërisë “Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.

Banka e ka zbatuar Metodologjine sipas Rregullores se Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise per Mjaftueshmerine e Kapitalit, miratuar me Vendimin Nr.48, date 31.07.2013 te Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise.
Banka e Shqiperise kerkon nga çdo banke apo Grup bankar:
(a) te mbaje nivelin minimal te kapitalit rregullator prej 1 miliard leke
(b) te ruaje nje raport total rregullator me asete te ponderuara me rrezik ne nivelin e pranuar nderkombetarisht prej 12% ose me lart, dhe qe Banka te veproje ne perputhje me keto kerkesa.

| Raporti i mjaftueshmërise së kapitalit | | Shuma |
|---|---|---|
| (në mijë lekë) | | |
| | **KAPITALI RREGULLATOR** | 1,143,526.37 |
| | **RMK (%)** | 12.50 |
| | **SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK** | 9,145,519.89 |
| | **RREZIKU I Financimit** | |
| **1** | **Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e financimit, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)** | 8,410,991.77 |
| **1.1** | Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit | 8,410,991.77 |
| **1.1.1** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qëndrore ose bankave qëndrore; | 0.00 |
| **1.1.2** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale; | 0.00 |
| **1.1.3** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse); | 0.00 |
| **1.1.4** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit; | 0.00 |
| **1.1.5** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare; | 0.00 |
| **1.1.6** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura; | 280,348.88 |
| **1.1.7** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave); | 1,014,144.61 |
| **1.1.8** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail); | 139,776.34 |
| **1.1.9** | Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme; | 5,689,232.83 |
| **1.1.10** | Ekspozime (financime) me probleme; | 521,361.19 |
| **1.1.11** | Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë; | 0.00 |
